

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 205 Prot.

Tiranë, më 08.03 2016

VENDIM Nr. 5, datë 29.02.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 42, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.2, të datës 29.02.2016, pasi shqyrtoi *Projektin e Restaurimit "Harku i Temenosit, Apolloni, Fier"*, paraqitur nga Instituti i Monumenteve të Kulturës.

VENDOSI:

- I. Të miratojë *Projektin e Restaurimit "Harku i Temenosit, Apolloni, Fier"*, paraqitur nga Instituti i Monumenteve të Kulturës.
- II. Në funksion të projektit të sipërpërmendur, pasi të jetë kryer më parë çmontimi i gurëve në tre radhët e para të harkut, të kryhen nga Instituti i Arkeologjisë në bashkëpunim me Parkun e Apollonisë sondazhe arkeologjike, duke filluar 60cm në dy anët nga aksi i harkut, deri sa të gjendet thellësia e themelit ekzistues, për verifikimin e gjendjes së tij. *Periudha e kryerjes së sondazheve do të konfirmohet nga IMK dhe do të realizohet në prani të projektuesit të këtij institucioni, me qëllim marrjen e masave në lidhje me të.*
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FLORINI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO